

Dok.	TIA-IMS-POL-002	<b>Politika e Cilësisë</b>	
Rish.	07		
Datë	01/07/2024		<b>I Brendshem/I Jashtem</b>

## POLITIKA E CILËSISË

Objektivi parësor i Tirana International Airport (TIA-s) është të njihet për ofrimin e shërbimeve efikase, të sigurta, dhe të klasit të parë për pasagjerët, linjat ajrore dhe përdoruesit e tjerë të aeroportit.


Tirana International Airport është e angazhuar që të arrijë nivelin më të lartë të mundshëm të standardit ndërkombëtar përsa i përket faciliteteve, sigurisë teknike (safety), sigurisë (security) dhe performancës të fokusuar në kënaqësinë e klientit, nëpërmjet:

- Zhvillimit, zbatimit dhe mirëmbajtjes së një Sistemi të Menaxhimit të Cilësisë (SMC), të orientuar drejt standardeve ISO 9001:2015, dhe duke siguruar që funksionet e SMC-së janë të integruara në mënyrë efikase me Sistemet e tjera të Menaxhimit brenda Kompanisë, dhe përmirësohen vazhdimisht gjatë aktiviteteve tona.
- Krijimit, zbatimit, rishikimit dhe përmirësimit të proceseve në përputhje me rregullat e zbatueshme dhe kërkesat rregullatore të përcaktuara nga autoritetet dhe agjencitë rregullatore kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Matjes së performancës për të arritur objektivat organizative dhe të lidhura me proceset dhe për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm në të gjitha aktivitetet që TIA kryen në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës. Ne jemi të angazhuar në optimizimin e operimit të Aeroportit, duke e kthyer TIA-n në një nga objektet më moderne infrastrukturore në Shqipëri.
- Kryerjes së aktiviteteve duke përfshirë në proceset tona nevojat dhe pritshmëritë e pasagjerëve tanë, klientëve tanë dhe partnerëve tanë.
- Promovimit të “një mendësie të bazuar në vlerësim risku dhe mundësie” duke adoptuar një përqsasje që lejon zbatimin e menaxhimit efikas të cilësisë, për zhvillimin e një kulture pozitive për cilësinë dhe sigurinë, çka do të garantojë që objektivat dhe synimet tona në lidhje me cilësinë të jenë të kuptueshme dhe të zbatueshme në të gjitha nivelet organizative të TIA-s.
- Përbushjes së të gjitha kërkesave për burime, të tilla si personel, infrastrukturë dhe pajisje, me fokus kryesor zhvillimin personal dhe profesional të punonjësve tanë nëpërmjet trajnimeve profesionale që plotësojnë nevojat e tyre të trajnimit për të zhvilluar dhe përmirësuar kualifikimet dhe kompetencat e tyre.
- Krijimit të rrjeteve efektive të komunikimit si brenda organizatës sonë ashtu edhe me klientët dhe partnerët tanë, për të siguruar kontributin e tyre drejt përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve brenda Aeroportit dhe zhvillimit të mëtejshëm të industrisë së aviacionit shqiptar.


Nëpërmjet promovimit në faqen tonë të internetit dhe marrëdhënieve me publikun, TIA kërkon të përforcojë një marrëdhënie të ngushtë me shoqërinë Shqiptare dhe publikun e gjerë, duke ofruar informacion transparent për të gjitha palët e interesuara dhe ne jemi të hapur për sugjerime nga përdoruesit e TIA-s në kuadër të përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë së shërbimit.

Tirana International Airport, 1 Korrik 2024

Marsida Pallko  
Administratore e TIA-s




Piervittorio Farabbi  
Menaxher Përgjegjës i TIA-s dhe  
Administrator / COO



Page 1 of 1